

ARTEMISA DRALO

**RRETH FORMAVE TË PASHTJELLUARA NË GJUHËT
E BALLKANIT**

Qysh herët Eqrem Çabej ka shprehur një opinion mjaft relativ, lidhur me tiparet e përbashkëta ballkanike, duke theksuar se: “Janë disa zhvillime të përbashkëta në sistemin fonetik, por si jo të përgjithësuara, ato nuk mund të trajtohen kudo, të tillat mund të hetohen më parë midis dy-tri gjuhëve, si midis shqipes e rumanishtes apo midis rumanishtes, greqishtes moderne e shqipes”. Normalisht, janë përshtatur dhe evidentuar mjaft shembuj që dëshmojnë më së miri tipare të përbashkëta në gjuhët ballkanike, prej shumë gjuhëtarëve e studiuesve të trevave të ndryshme, madje dhe përtej Ballkanit. Në rrafshin diakronik, ajo që ka dominuar pa ndryshime rrënjësore në thelb, por kryesisht në funksion, ka qenë fenomeni i humbjes së infinitivit në këto gjuhë. Infinitivi, ose paskajorja e shqipes, fillimisht përpara analizës së shkaqeve të humbjes së vet, duhet parë paraprakisht në përcaktimin përkufizimit dhe kategorizimit, në grupin e formave të pashtjelluara. Pra, çfarë është paskajorja (infinitivi), si kategorizohet në gjuhë të ndryshme, çfarë funksione merr në gërshetim me pjesët e tjera? Gjithashtu, shumë pyetje janë ngritur prej shumë studiuesve, por që ndoshta nuk kanë arritur në një unanimitet mendimesh përfundimtare.

Ndoshta çështja e definicionit mund të dëgjohet si një problem i vogël dhe jo me vështirësi në zgjidhje, por është larg prej të qenit e thjeshtë, për arsye se nuk duket të ketë një set me parametra për një përcaktim të një elementi të tillë gjuhësor, që është universalisht i vlefshëm dhe kjo vlen për gjithë gjuhët natyrale. Në aspektin diakronik, gjuhë të tjera që kanë ekzistuar në familjen e gjuhëve në Ballkan, por vetëm pjesërisht në historinë e tyre, si për shembull më dukshëm gjuha e ciganëve romanishtja, gjuha e egjiptianëve (gypsies) dhe Ladino (gjuha e një kombinimi të hebraishtes me elemente greke dhe turke), shfaqin gjithashtu disa elemente të cilat i kanë shënuar ato në gjuhët ballkanike. Në mënyrë tipike, thuhet se edhe ato duhet t’i jenë nënshtruar fenomenit të humbjes së infinitivit. Duhet përmendur këtu se turqishtja përjashtohet nga ky varg për arsye se ajo nuk bën pjesë në paralelet morfosintaktike ndërmjet gjuhëve ballkanike. Studime të tilla kanë sjellë efekte të mjaftueshme mbi

pikëpamjet individuale të trajtimit të fenomenit të infinitivit ballkanik, sepse është e pamundur të thuhet nëse infinitivi ka humbur prej një gjuhe, nëse nuk është pranuar fillimisht se çfarë është infinitivi për atë gjuhë. Gramatikanët tradicionalë, duke përfshirë edhe gjuhëtarët shqiptarë, kanë lënë boshllëk në këtë aspekt gjuhësor dhe në vitet e fundit studiuesit janë marrë me analizimin e fenomenit të formave të pashtjelluara duke ngritur pyetje thelbësore mbi natyrën e ndryshueshmërisë ndërgjuhësore në fushën morfologjike dhe semantike. Një nga qëllimet kryesore të kërkimit në fushën e sintaksës është të përcaktojë marrëdhënien midis kuptimit dhe përdorimit. Për këtë arsye format e pashtjelluara janë konsideruar si një burim i pasur studimi për çdo drejtim gjuhësor. Është ngritur pyetja se sa forma të pashtjelluara gjenden në gjuhën shqipe dhe sa janë ekuivalentet e tyre në gjuhën angleze, si gjuhë ndërkombëtare dhe me një peshë madhore në krahasimet gjuhësore të shumë metodologjive të mësimdhënies, ose madje si janë kategorizuar dhe përdorur në format standarde apo dialektore të dy gjuhëve?!

Në vazhdimësi të studimeve dhe kërkimeve gjuhësore, përkatesisht në pjesën e dytë të shek. XX, këto studime morën një këndvështrim të ri. Në të njëjtin ritëm studimi me zhvillimet teorike në fushën e kontakteve të gjuhëve, u thellua edhe përmasa e përparësive të ngjashme në gjuhët e kësaj familjeje, për pasojë të jetës së përbashkët dhe të kontakteve midis gjuhëve. Janë kapur në mënyrë të detajuar, aspekte themelore të ngjashmërive midis këtyre gjuhëve, që përbëjnë veçanti në raport me kriterin e pozicionit gjeografik të gjuhëve të tjera, janë zhvilluar dhe hapur diskutime për përfshirjen teorike të rezultateve të dëshmuara të këtyre studimeve dhe u përforcuan si pasojë e gjithë kësaj problematike, gjithmonë e më gjerazi, hulumtimet në terren. Koncepti ballkanik mbi botën, në termat e tipareve të përbashkëta mbi gjuhën, nuk është pa dyshim i një rëndësie të vogël, por për më tepër i vlerësuar e diskutuar gjerësisht në terrene të shumta nga të gjitha pikëpamjet e mundshme. Në konceptin e *Sprachbundit*¹, pra të unionit gjuhësor ballkanik, u bë një dallim i qartë midis gjuhëve ballkanike me tipare të këtij Sprachbundi dhe gjuhëve të Ballkanit me tërë kontradiktën, për kapërcimin e së cilës implikohen shpesh argumentime jashtëgjuhësore. Për sa i përket shqipes së vjetër, janë hedhur teori dhe fakte se ekzistenca e saj mendohet të ketë zanafillën 2500 vite para, por edhe se ndikimi i saj në zhvillimin e gjuhëve ballkanike ka

¹ B. D. Joseph, *The synchrony and the diachrony of the Balkan Infinitive*, Cambridge University Press, 1983, f. 255.

qenë i rëndësishëm. Format e pashtjelluara përbëjnë një ndër çështjet më të vështira e më të diskutuara në gramatikën e shqipes, por edhe në gjuhë të tjera. Nisur me aspektin e emërimit, apo përkufizimin e trajtimit të tyre, ka pasur e vazhdon të ketë qëndrime të ndryshme. Në përgjithësi, forma të pashtjelluara të foljes në shqipe konsiderohen ato folje që gjatë zgjedhimit të tyre nuk ndryshojnë sipas vetës e numrit, në kundërvënje me format e shtjelluara të foljes, të cilat ndryshojnë sipas vetës e numrit. Gjithashtu, në dallim nga format e shtjelluara të foljes, format e pashtjelluara karakterizohen nga mungesa e kategorisë gramatikore të mënyrës. Veçanërisht ky tipar i fundit, ka bërë që të lindin mospajtime të mëdha midis gramatikanëve, për shkak se mënyra, në teorinë sintaksore që mbizotëron gramatikën shqipe, përbën tiparin themelor të kallëzuesisë. Në bazë të tiparit të modalitetit përcaktohet nëse këta përbërës formojnë fjali apo vetëm gjymtyrë fjalie. Gjithashtu, për statusin kategorial të disa prej formave të pashtjelluara të shqipes standarde ka mendime të ndryshme.

Brian Joseph është i mendimit se format e pashtjelluara të tipit *për të bërë* në dialektin tosk e shqipen standarde dhe *me ba* në dialektin geg, i përkasin të dyja kategorisë së infinitivit. Sipas autorit, t'i quash forma të pashtjelluara foljore, do të thotë të mos i kategorizosh ato. Diakronikisht, shprehet Joseph, funksioni primar i tipit *për të punuar* ka qenë shprehja e qëllimit, në përputhje me derivimin e kësaj forme nga parafjala *për + folje e emëruar*, ndoshta *pjesore e substantivuar*. Me zgjerimin e funksioneve si plotësor i emrave, foljeve dhe mbiemrave, ka zënë fill përtëritja e kategorisë së infinitivit².

Në kapitullin kushtuar shqipes, Joseph e hulumton infinitivin e shqipes standarde si një tipar ballkanik, i cili është zëvendësuar me forma të shtjelluara foljore, përkatësisht nga lidhorja. Ai bën dallim midis infinitivit tosk të tipit *për të bërë*, që përbën bazën e infinitivit të shqipes standarde, dhe infinitivit geg të tipit *me ba* për sa i përket distribucionit të tyre dhe shkallës së zëvendësimit nga lidhorja. Infinitivi geg ka distribucion më të gjerë dhe është zëvendësuar më pak nga lidhorja. Pavarësisht se të dy tipet e infinitivëve të shqipes janë zëvendësuar deri në një farë mase nga lidhorja, ashtu si dhe gjuhët e tjera ballkanike, të dyja format e infinitivit janë të gjalla e aktive në gjuhën shqipe. Në aspektin sinkronik, infinitivët e shqipes zbërthehen *me + pjesore* dhe *për të + pjesore*, të cilat

² B. D. Joseph, *The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive*, Cambridge University Press, First published in 1983, 2009, f. 99.

interpretohen gramatikisht si *pjesëz + infinitiv*³. Autori mendon se *për të + pjesore* nuk mund të pranohet si infinitiv i përbashkët i shqipes. Këndej, sipas autorit, mbeten dy mundësi: ose *me + pjesore* është infinitivi i përbashkët i shqipes, ose të dyja trajtat infinitivale *me + pjesore* dhe *për të + pjesore* përfaqësojnë zëvendësuesit e infinitivit të përbashkët të shqipes, i cili tashmë ka humbur⁴. Infinitivi tosk/ i standardit me *për të + pjesore* ose ka zëvendësuar infinitivin e përbashkët të mbarë shqipes *me + pjesore*, ose ka zëvendësuar drejtpërdrejt infinitivin e dikurshëm të humbur të shqipes. Në këtë rast, vazhdon autori, mund të flitet për një ripërtëritje të dytë të kategorisë së infinitivit në toskërisht, e cila duhet t'i ketë fillësat rreth 1000 vjet më parë, periudhë në të cilën shqipja, ashtu si dhe gjuhët e tjera ballkanike, po i nënshtrohej zgjerimit të plotësive të shtjelluar⁵. Hipotezën e një paskajoreje të rigjallëruar të toskërishtes e pranon edhe M. Gabinski dhe Sh. Demiraj⁶. Shumë albanologë të huaj hasin një përplasje me këtë terminologji pasi ashtu si gjuhëtarët shqiptarë, me termin *Gjerund* zakonisht emërtojnë përcjelloren e tipit *duke bërë*. Kështu pra, kjo risi është ndeshur me problematika komplekse që kërkojnë pa dyshim një vëmendje thelbësore për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Secila nga format e pashtjelluara, ashtu siç edhe u përmend më lart, shfaq probleme terminologjike. Por ajo që njihet është se sipas Gramatikës së Gjuhës shqipe, gerundi nuk është njohur si formë e veçantë dhe kërkon një ristudim në bazë të të dhënave që kanë dalë në vazhdim të kërkimit të një definicioni përfundimtar të këtyre formave.

Terminologjia varion në bazë të funksionit sintaksor por edhe formës morfologjike që shfaqin në gjuhë të ndryshme këto forma. Forma e pashtjelluar e *gerundit* është përshtatur si *gerund* në gjuhën shqipe nga Çeliku⁷, është në përdorim me termin *gerund* në latinisht, *gerund* në anglisht, *supin* në rumanisht, etj., por që funksioni i tij varion sipas gjuhëve të ndryshme. Termi *përcjellore* që i përket terminologjisë tradicionale me shembullin *duke punuar* në gjuhën shqipe, në rusisht emërtohet me termin *djejpriçastje*, *gerondif* në frëngjisht, *gerundio* në italisht dhe spanjisht, *gerunziu* në rumanisht, *glagolski prilog* në

³ Po aty, f. 94.

⁴ Vep. cit., f. 98.

⁵ Po aty, f. 99.

⁶ Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës, Prishtinë, 1970.

⁷ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2000, Shtëpia Botuese e Librit Universitar.

serbokroatishte, *γερούνδιο* në greqisht, por edhe në gjuhë të tjera. Por ajo që duhet të kemi gjithmonë parasysh është se kjo terminologji nuk i përgjigjet të njëjtës formë në gjuhën shqipe, pasi funksionet e saj sintaksore dhe kategorizimi sipas tyre ndryshojnë nga gjuha në gjuhë. Dhe më konkretisht, në gjuhën shqipe këtij termi i përgjigjen format e trajtës të *bërë*, e rasës kallëzore, dhe së *bëri* e rasës rrjedhore. Ka disa gjuhë që përcjelloren e trajtojnë si gerund me funksion ndajfoljor ashtu si edhe në shqip gerundi mund të cilësohet nga gërshetimi folje dhe emër dhe shpeshherë ndajfolje. Çeliku⁸, në studimet e tij, e shtron qartë këtë kategorizim të dy trajtave të përcjellores, *duke punuar* dhe *pa punuar*. Për infinitivin përshtat formën me + particip: *me ardhë*, *me marrë*, pasi shqipja nuk ka trajtë të vetën, dhe këtë autori e quan infinit perifrastik dhe përfshin dy format e tij, prezentin dhe të shkuarin.

Historia e infinitivit në gjuhët ballkanike

Zhvillimet historike të një vendi lidhen ngushtë si me zhvillimet kulturore e sociale, po ashtu edhe me zhvillimet gjuhësore të tij. Ajo që jemi duke studiuar aktualisht, përqendrohet në terrenet ballkanike, por pa shmangur aspekte të ngjashme në gjuhët e tjera indoeuropiane e veçanërisht në gjuhën angleze. Faktet që i përkasin humbjes së infinitivit, si edhe zëvendësimit të tij me forma të shtjelluara, i detyrohen vetë rrjedhës historike. Gjuhëtarët ballkanas kanë shfaqur interes kryesisht mbi disa fusha të përcaktuara për studime të mëtejshme, rreth kësaj problematike. Më konkretisht duhet përmendur, për t'u rishikuar në perspektiva të reja, çështja e pasojave të humbjes së infinitivit për sistemin foljor të secilës gjuhë, pasojat sintaktike të zëvendësimit të infinitivit me forma të shtjelluara foljore, si edhe paralele të reja që ngrihen midis gjuhëve ballkanike. Disa studiues e kanë konsideruar gjuhën greke si shembullin më efikas të këtij fenomeni, kryesisht në studime të rrafshit diakronik. Kjo nënkupton se greqishtja mund të jetë një standard krahasimi për efekte të ndryshme si edhe për dukuri të humbjes së infinitivit në gjuhët e tjera. Si pasojë ajo është përcaktuar si burimi i këtij fakti gjuhësor. Fenomeni i formave të pashtjelluara ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen e gjuhëtarëve, prandaj për këtë temë ka një literaturë të gjerë. Termi *forma të pashtjelluara* në kuptimin tradicional u referohet përbërësve që nuk përshtaten në vetë dhe në numër. Ato dallohen nga opozicioni me format e

⁸ M. Çeliku, 1986, *Kuptimet dhe përdorimet sintaksore të trajtës së tipit pa punuar në gjuhën e sotme letrare shqipe*, në "Studime filologjike", nr. 3, f. 91-114.

tjera foljore, të cilat përshtaten në vetë, numër etj. Vetë termi *i pashtjelluar* nënkupton se bëhet fjalë për forma gramatikore të pashtjellueshme të foljes, d.m.th. forma foljore që nuk mund të shtjellohen (ndryshojnë) në vetë dhe në numër. P.sh.:

- He wants **to speak**. (anglisht)
- Ai dëshiron **me folë**. (gegërisht)
- Ai dëshiron **të flasë**. (shqipe standarde/toskërisht)
- Aftós thélei **na milísei**. (greqishte e re)
- El vrea **să vorbească**. (rumanisht)

Të gjithë shembujt e mësipërm kanë të njëjtin kuptim, porse folja *flas* është realizuar me forma të ndryshme foljore. Në gjuhën angleze folja *flas* realizohet me një formë foljore të pashtjelluar, *to speak*, në të cilën pjesëza *to* shërben për të formuar infinitivin. Në mënyrë të ngjashme, në gegërishte, dialektin verior të gjuhës shqipe, folja *flas* realizohet me një formë të pashtjelluar foljore, *me folë*, ku *me* është pjesëz gramatikore që shërben për të formuar infinitivin. Në shqipen standarde (kuptohet dhe në toskërisht) folja *flas* realizohet me një formë të shtjelluar foljore, *të flasë*, në të cilën *të* është pjesëz gramatikore që shërben për të formuar lidhoren. Në gjuhën greke folja *flas* është realizuar gjithashtu me një formë foljore të shtjelluar në mënyrën lidhore: *na milísei*, ku *na* është pjesëz e mënyrës lidhore. Në gjuhën rumune folja *flas* është realizuar me një formë foljore të shtjelluar të mënyrës lidhore *să vorbească*, ku *să* është pjesëz që shërben për të formuar lidhoren. Pra, në shqipen standarde, në greqishten e re dhe në rumanishte funksionin e infinitivit të gjuhëve të tjera (anglisht, gegërisht) e kryen lidhorja.

Një klasifikim i sistemit foljor sipas tiparit [$\pm$ i shtjelluar] tashmë është argumentuar nga studiuesit për gjuhët indoevropiane. Klasifikimi binar i foljeve në këto gjuhë sipas tiparit [$\pm$ i shtjelluar] mbështetet në kriteret morfologjike, sintaksore dhe distribucionale. Kriteri morfologjik ka të bëjë me morfemat që markojnë vetën, numrin, kohën. Kriteri sintaksor ka të bëjë me përshtatjen e foljes me kryefjalën, ndërsa kriteri distribucional lidhet me format foljore që hyjnë në të njëjtën paradigëm. Gjuha shqipe ka një sistem të pasur eptimor dhe kriteri morfologjik luan rol të dorës së parë në ndarjen e foljeve në të shtjelluara dhe të pashtjelluara.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F. (1983), *Vëzhgime mbi formën gramatikore pa + pjesore*, në “*Studime filologjike*”, nr. 3, Tiranë.
- Agalliu, F. (1988), *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, Shtypshkronja “Mihal Duri”.
- Çeliku, M. (2000), *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Çeliku, M. (2012), *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*, Tiranë, ILAR.
- Çeliku, M. (2013), *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- Çeliku, M. (2013), *Koncepte dhe terma të rinj të sintaksës shqipe*, “*Studime filologjike*”, nr. 12.
- Demiraj, Sh. (1971), *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe*, në “*Studime filologjike*”, nr. 1.
- Demiraj, Sh. (1977), *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, “*Studime filologjike*”, nr. 3.
- Biber D. et al. (1999), *Longman Grammar of Spoken and Written English*. Harlow: Pearson Education Limited.
- Duffley, P. J. (2000), *Gerund versus Infinitive as Complement of Transitive Verbs in English*, “*Journal of English Linguistics*”, 28 (3): 221-248..
- Duffley, P. J. (2003), *The Gerund and the to-Infinitive as Subject*. “*Journal of English Linguistics*”, 31 (4): 324-352.
- Joseph, B. D. (2009), *The synchrony and diachrony of the Balkan infinitive: a study in areal, general, and historical linguistics*. Cambridge: Cambridge University Press. First published in 1983.
- Kananaj, A. (2015), *Rrethanori në gjuhën shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Mansaku, S. (1979), *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, në “*Studime filologjike*”, nr. 3, Tiranë.
- Mansaku, S. (1980), *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskajore tek autorët e vjetër*, në “*Studime filologjike*”, nr. 2. Tiranë.
- Memishaj, V. (2007), *Rreth mbiemrave prejpjesorë në shqipe dhe në greqishte*, në “*Studime filologjike*”, nr. 3-4. Tiranë.

